



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. l prot. 3989 Më 05.12.2025
Br. prot. Dt.
RAHOVEC - ORAHOVAC

RAPORT VJETOR I PUNËS DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE

KOMUNA RAHOVEC

JANAR – DHJETOR 2025

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME.....	2
STATISTIKA – GJOBA MANDATORE DHE REALIZIM I TË HYRAVE.....	6
PËRFUNDIM.....	8

PËRMBLEDHJE E PËRGIJTHSHME

Drejtoria për Punë Inspektuese në Komunën e Rahovecit ka për detyrë kryesore mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve komunale, me qëllim të sigurimit të një mjedisi të rregullt, të sigurt dhe funksional për qytetarët. Gjatë periudhës janar – dhjetor 2025, kjo drejtori ka realizuar një sërë aktiviteteve konkrete në pesë sektorë të ndarë funksionalisht: ndërtimi, mjedisi, çështjet komunale, tregu dhe transporti publik.

Gjatë këtij viti, drejtoria ka përforcuar qasjen inspektuese përmes rritjes së pranisë në terren, bashkëpunimit të ngushtë me institucionet e rendit dhe organeve gjyqësore, si dhe përmes përfshirjes aktive të qytetarëve në raportimin e shkeljeve, veçanërisht në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Në këtë drejtim, themelimi i fondit për shpërblimin e raportuesve të ndotjes ka rezultuar me rritje të ndjeshme të raportimeve qytetare, duke dëshmuar rëndësinë e përfshirjes së komunitetit në monitorim dhe veprim konkret për ruajtjen e mjedisit.

1. SEKTORI I NDËRTIMIT

Gjatë kësaj periudhe, Sektori i Ndërtimit ka intensifikuar kontrollet me fokus te objektet e kategorisë së parë:

- Janë kryer **84 inspektime** në terren;
- Janë shqiptuar **71 gjoba mandatore** për ndërtim pa leje;
- Në raste me parregullsi teknike ose procedurale, janë lëshuar **vendime për ndërprerjen e punimeve**.

Inspektimet kanë përfshirë analizën e dokumentacionit teknik, verifikimin e kushteve ligjore dhe ndjekjen e procedurave për legalizim të ndërtimit.

2. SEKTORI I MJEDISIT

Ky sektor është përqendruar në mbrojtjen aktive të mjedisit përmes inspektimeve dhe veprimeve ndëshkimore:

- Janë realizuar kontrolle të rregullta nga inspektori i mjedisit;
- Janë shqiptuar **65 gjoba mandatore** për ndotje të mjedisit;
- Janë inspektuar **23 biznese** që ushtrojnë veprimtari të ndjeshme për mjedisin;

- **21 prej tyre** kanë aplikuar për leje mjedisore, **16 janë pajisur**, 1 është refuzuar dhe **5 janë në proces shqyrtimi**.

RISI E KËSAJ PERIUDHE:

Pas themelimit të fondit për shpërblim të raportimeve qytetare për ndotje, është regjistruar rritje e ndjeshme e numrit të raportimeve për raste të ndotjes mjedisore. Kjo nismë ka përmirësuar efikasitetin e sektorit dhe ka fuqizuar rolin aktiv të qytetarëve në ruajtjen e mjedisit të pastër dhe të shëndetshëm.

3. SEKTORI I ÇËSHTJEVE KOMUNALE

Ky sektor është përballur me kërkesa të shumta që lidhen me funksionimin e përditshëm të infrastrukturës publike:

- Janë trajtuar ankesa dhe kërkesa të qytetarëve, kryesisht për rrjetin e kanalizimit dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike;
- Janë shqiptuar **20 gjoba** për shkelje të rregullave për përdorimin e hapësirave publike;
- Janë lëshuar **36 aktvendime kundrejt KRU Gjakova** për garantimin e zhvillimit të ligjshëm të aktiviteteve të saj;
- **101 shfrytëzues** të hapësirave publike janë urdhëruar të pajisen me leje të rregullta.

Ky sektor ka qenë proaktiv në sigurimin e një infrastrukture funksionale dhe në promovimin e sjelljes së përgjegjshme qytetare.

4. SEKTORI I TREGUT

Sektori i tregut ka punuar në garantimin e standardeve të shitjes, formalizimin e bizneseve dhe mbrojtjen e konsumatorëve:

- Janë kryer inspektime të rregullta në dyqane dhe markete;
- Janë shqiptuar **2 gjoba mandatore** për mungesë dokumentacioni dhe mospërputhje në çmime;
- Janë verifikuar peshoret në tregjet e bukës për saktësi të matjeve;
- **33 biznese të reja janë regjistruar** në ARBK pas ndërhyrjes së inspektoratit;

- Po aq pëlqime pune janë lëshuar për subjektet që kanë përmbushur kriteret higjienike dhe teknike.

Sektori ka synuar formalizimin e tregut dhe përmirësimin e cilësisë së produkteve të ofruara për qytetarët.

5. SEKTORI I TRANSPORTIT PUBLIK DHE KOMUNIKACIONIT

Ky sektor ka mbikëqyrur shërbimet e transportit publik me fokus në sigurinë dhe rregullsinë:

- Janë monitoruar linjat e autobusëve dhe shërbimet e transportit të licencuar;
- Janë kontrolluar autotaksitë dhe është urdhëruar **vazhdimi i lejeve për transport udhëtarësh**;
- Janë ndërmarrë masa për të garantuar një transport publik të sigurt dhe në përputhje me normat e parashikuara.

6. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET E TJERA

Drejtorja ka pasur një bashkëpunim të ngushtë dhe të qëndrueshëm me:

- **Policinë e Kosovës**, për mbështetje në zbatimin e urdhrave administrativë;
- **Gjykatat**, për procedimin e shkeljeve dhe zbatimin e aktvendimeve;
- Organe të tjera të administratës komunale për mbështetje në sektorët e infrastrukturës, mjedisit dhe transportit.

Ky bashkëpunim ndërinstytucional ka ndihmuar në forcimin e rendit dhe rritjen e besueshmërisë institucionale.

SFIDA DHE REKOMANDIME

SFIDA:

- Rezistencë nga ana e qytetarëve dhe bizneseve për t'u pajisur me dokumentacion ligjor;
- Prezencë e vazhdueshme e ndërtimeve pa leje në disa zona të komunës;
- Kapacitete të kufizuara njerëzore dhe logjistike në disa sektorë inspektimi.

REKOMANDIME:

- Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe bizneseve për rëndësinë e përmbushjes së kushteve ligjore;
- Zgjerimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për të siguruar zbatim më të plotë të ligjeve;
- Rritja e numrit të inspektorëve dhe trajnimi i tyre për menaxhim më efikas të rasteve;
- Përdorimi i **teknologjive moderne për mbikëqyrje** dhe raportim në kohë reale;
- Zgjerimi i **fondit për shpërblimin e raportimeve qytetare** dhe promovimi i këtij mekanizmi si mjet efikas për ruajtjen e mjedisit.

STATISTIKA – GJOBA MANDATORE DHE REALIZIM I TË
HYRAVE

LLOJI I NDËSHKIMIT	NUMRI I GJOBAVE TË SHQIPTUARA	VLERA E GJOBËS NË €
GJOBA MANDATORE PËR NDËRTIM PA LEJE	71	23.680.00€
GJOBA MANDATORE – ÇËSHTJE KOMUANLE	20	2400€
GJOBA MANDATORE - TREGU	2	1000€
GJOBA MANDATORE PËR MJEDIS	65	5200€
<u>TOTALI:</u>	158	32, 280.00€

LLOJI I VEPRIMIT	NUMRI I KËRKESAVE	VLERA NË €
KËRKESA PËR KONTROLL INSPEKTUES	39	390€
PËLQIME PUNE	76	1140€
<u>TOTALI:</u>	112	1530 €

<u>TOTALI I TË HYRAVE NË DPI:</u>	<u>JANAR – DHJETOR</u> <u>2025</u>	<u>33,810.00€</u>
------------------------------------------	-----------------------------------------------------	--------------------------

SHTOJCË- INDIKATORËT E PERFORMANCËS;

FUSHA 7: PLANIFIKIMI HAPËSINOR KOMUNAL

Komuna	Rahovec
Referenca	7.2.2
Fusha	PLANIFIKIMI HAPËSINOR KOMUNAL
Rezultati	Ndërtim i planifikuar komunal
Emri i treguesit	Ndërtesa të reja të inspektuara

- Numri i përgjithshëm i objekteve të reja të inspektuara gjatë vitit të raportimit – 84;
- Numri i objekteve të reja me leje të ndërtimit nga objektet e inspektuara – 71.

FUSHA 15: MBROJTJA E MJEDISIT

Komuna	Rahovec
Referenca	12.1.3
Fusha	MBROJTJA E MJEDISIT
Rezultati	Krijimi i një mjedisi të pastër dhe të shëndetshëm
Emri i treguesit	Ndërtesat e reja që e kanë zbatuar lejen mjedisore komunale

- Numri i objekteve të reja për të cilat kërkohet leje mjedisore të inspektuara gjatë vitit të raportimit – 23;
- Numri i gjobave të shqiptuara për mos posedimin dhe zbatimin e LMK – 5;
- Numri i I bizneseve te pajisura me LMK – 16.

PËRFUNDIM

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2025 Drejtoria për Punë Inspektuese në Komunën e Rahovecit ka shënuar progres të dukshëm në drejtim të zbatimit të legjislacionit dhe forcimit të rendit komunal. Aktivitetet inspektuese të kryera në të gjitha sektorët relevantë kanë kontribuar në përmirësimin e funksionalitetit urban, mbrojtjen e mjedisit, garantimin e standardeve tregtare dhe sigurimin e transportit publik të rregullt.


Veçanërisht vlen të theksohet ndikimi pozitiv i nismës për themelimin e fondit për shpërblimin e raportimeve për ndotje të mjedisit, e cila ka përforcuar rolin e qytetarëve si pjesë aktive në zbatimin e ligjit dhe ruajtjen e ambientit.

Pavarësisht sukseseve, sfidat mbeten prezente – nga mungesa e vetëdijes për dokumentacion ligjor, tek ndërtimet pa leje dhe mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme për mbulimin e të gjitha nevojave në terren. Këto sfida kërkojnë vazhdim të përkushtimit institucional, përmirësim të vazhdueshëm të kapaciteteve profesionale, dhe sidomos thellim të bashkëpunimit me institucionet e tjera dhe qytetarët.

Në muajt në vijim, drejtoria synon të zbatojë qasje edhe më proaktive, duke investuar në trajnime, teknologji të reja dhe përfshirje të komunitetit për një menaxhim më të mirë të hapësirës publike, ligjshmërisë dhe mirëqenies qytetare.

Përmes punës së përbashkët, transparencës dhe vendosmërisë, synojmë të ndërtojmë një Rahovec më të rregullt, më të pastër dhe më të sigurt për të gjithë.

Nora BOSHNJAKU



Drejtore për Punë Inspektuese

